



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE

Numri i Ceshtjes : 31154-06415-80-2019      Data e Regjistrimit : 17/10/2019  
Numri i Vendimit: 80-2020-1753              Data e Vendimit : 27/07/2020

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 27/07/2020mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

Padites Shoqeria {...} Paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale (DPPI)

Objekti:Shfuqizimi i aktit administrate nr. 66/16, date 11.09,2019 te Bordit te Apeiit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ("DPPI"). 2. Vazhdimi i procedurave nga DPPI per regjistrimin e markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/66 ne emer te Paditesit.

Baza Ligjore:Nenet 142, 150, 184/? te Ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" i ndryshuar -Nenet 100, 113, 114, 139 te Kodit te Procedurave Administrative -Ligji nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative"

Gjykata pasi i dha fund hetimit gjyqesor dhe ftoi palet ndergjyqese te parashtrojne pretendimet perfundimtare, ku perfundimisht pala paditese kerkoi pranimin e kerkese - padise, pala e paditur perfundimisht kerkoi rrezimin e kerkese - padise, si dhe pasi shqyrtoi ne teresi rrethanat e geshtjes dhe gmoi provat e marra ne seance gjyqesore.

VEREN :

## Veren:

Se pala paditese Shoqeria {...} ka paraqitur per gjykim prane Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane kerkese - padine me, objekt dhe baze ligjore te sipercituar.

Fillimisht kjo ceshtje ka qene objekt shqyrtimi prane nje tjetër trup gjykues prane gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane. Per shkak te doreheqjes se trupit gjykues kjo ceshtje administrative ka kaluar per shqyrtim prane ketij trupi gjykues me shortin elektronik te dates 21.01.2021.

Pergjate gjykimit pala paditese paraqiti nje kerkese per shtimin e objektit te padise. Kjo kerkese pasi iu komunikua rregullisht paleve ndergjyqese ne mungese ne baze te nenit 185 te Kodit te Procedures Civile dhe ne baze te parimit absolut te drejtes se pales paditese per te disponuar mbi padine e saj u pranua nga gjykata. Pas ketij veprimi procedural objekti i kerkesepadise eshte si me sipercituar ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

### **a) . Nga hetimi gjyqesor i geshtjes rezultuan te provuara keto fakte:**

-Nga provat e administruar ka rezultuar se pala paditese Shoqeria {...} sh.p.k. eshte pronare e markes tregtare B-52, pije energjike, pronesi te cilen ajo e ka fituar nepermjet transferimit te pronesise me ane te Kontrates se Shitjes date 16.06.2010 nga shoqeria e se drejtes maqedonase {...}. Marka tregtare ne Republiken e Shqiperise eshte regjistruar fillimisht nga subjekti {...} me date aplikimi 18.04.2008 dhe me date regjistrimi 06.11.2008, me kohezgatje te mbrojtjes deri ne date 18.04.2018. Lista e mallrave dhe/ose sherbimeve eshte Klasa 32 sipas klasifikimit nderkombetar te Nice - pije jo-alkoolike, pije energjike, pije sportive.

-Me vendimin me nr 11243-02435-00-2014 i Regj. Themeltar dhe me nr Nr. 00-2017- 2074 i Vendimit (112) date 05.10.2017 Gjykata e Larte Kolegji Civil eshte vendosur Lenien ne fuqi te vendimit nr. 1868, date 06.05.2014, te Gjykates se Apelit Tirane. Me vendimin me nr. 1868, date 06.05.2014 te Gjykates se Apelit Tirane eshte vendosur lenia ne fuqi e vendimit nr. 7121, date 24 .06.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Me vendimin nr. 7121, date 24 .06.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur shfuqizimi i mbrojtjes se markes B- 52 me nr regjistrimi 1082916 me pronar palen paditese ne kete gjykim Bavaria NV.

- Pala e paditese Shoqeria "Bavaria"N.V. eshte nje shoqeri tregtare e themeluar sipas legjislacionit hollandez, e cila eshte regjistruar si person juridik me nr. 17007387 regjistrimi, date 05.03.1931, referuar Ekstraktit te regjistrimit tregtar te Dhomes se Tregtise se Brabant, Eindhoven, me nr. regjistrimi 17007387, date 05.03.1931, me seli ne Lieshout, Hollande.

-Paditesi ka paraqitur prane DPPI ne daten 23.10.2018 kerkesen per regjistrimin e markes {...} Nr AL/T/2018-66;

- Pala e paditur DPPI pasi eshte njohur me kete aplikim per regjistrimin e markes me numer kerkese AL/T/2018/66, te paraqitur nga pala paditese, ka nxjere aktin nr. 66/10, dt. 02.10.2018: "Njoftim per refuzimin e regjistrimit te markes". Shkaku i cituar ne kete vendimarrje si shkak per refuzimin e kesaj marke eshte fakti se marka me nr. aplikimi AL/T/2018/66 si pales se paditur rezulton identike me marken me nr. regjistrimi nderkombetar 1082916, mbi te cilen aplikanti e ka humbur te drejten e pronesise me vendim te gjykates se formes se prere per shkak ligjor.

-Pala paditese e ka ankimuar kete vendim ne rruge administrative. Ne kuader te shyrtimit te ankimit administrativ rezulton se pala e paditur me aktin me nr 66/13. prot date 01.02.2019 ka vendosur lenien ne fuqi te qendrimit te saj te meparshem te pasqyruar ne aktin me nr 66/10, dt. 02.10.2018: "Njoftim per refuzimin e regjistrimit te markes".

-Pala paditese e ka ankimuar edhe kete vendim ne rruge administrative. Ne kuader te shyrtimit te ankimit administrativ rezulton se pala e paditur, Bordi i Apelit me aktin me nr 66/16. prot date 07.06.2019 ka vendosur lenien ne fuqi te qendrimit te saj te meparshem te pasqyruar ne vendimin me nr 66/13, date. 01.02.2019 te Dhomes.

-Pala paditese duke mosqene dakort me keto vendimarrje te pales se paditur paraqet kete padi ne gjykate.

### **b) Pretendimet dhe prapsimet e paleve ndergjyqese.**

Pala paditese parashtron ne kete gjykim disa pretendime baze:

-Lista e shkaqeve absolute qe parashikohet ne nenin 142 te Ligjit 9947 nuk perfshin vendimet gjyqesore si pjese perberese te shkaeve absolute. E thene ndryshe, vendimet gjyqesore nuk bejne pjese ne asnje nga shkaqet absolute te parashikuara ne nenin e permendur 142. Shkaqet absolute te parashikuara ne nenin 142 te Ligjit 9947 jane shteruese;

- Per me teper, vendimi 1868 te cilit i referohet DPPI-ja, nuk ka te njejtin objekt dhe as te njejtin shkak ligjor me ceshtjen qe eshte ne shqyrtim ne DPPI. Prandaj, per kete arsye, argumentimi i DPPI-se eshte teresisht i gabuar dhe i pambeshtetur ne ligj;

- Me tej, sic pranohet ne njoftim, marka nderkombetare {...} me numer nderkombetar IR1082916 ka statusin e "shfuqizuar nga gjykata", qe do te thote se, pas shfuqizimit kjo marke nuk ekziston me. Keshtu, sipas nenit 173(3) te Ligjit 9947, cdo marke e regjistruar qe shfuqizohet, konsiderohet si e paqene qe nga data e depozitimit te saj. Rrjedhimisht, DPPI nuk mund t'i referohet nje marke qe nuk ekziston. Por nje marke tjetër identike tjetër te meparshme qe egziston;

-Edhe nese do te behej ky krahesim ne rastin konkret marka qe ne kerkojme te regjistrojme nuk ka asnje ngjashmeri me marke tjetër te meparshme te cdo subjekti tjetër e cila eshte ende e aktive dhe e regjistruar.

- Rrjedhimisht, krahasimi i bere ne permbajtjen e Njoftimit te Refuzimit 66/10 se "*{...} konsiderohet e njejte me marken IR 1082916, te shfuqizuar me vendim gjykate*" eshte i gabuar dhe i pabazuar;

-{...} me numer AL-T-2018-66 nuk ishte obiekt ankimi, prandaj, efektet e vendimit te Gjykates se Larte nuk mund te shtrihen tek kjo marke. Ne kete aspekt nuk mund te pretendohet se vendimi i formes se prere duhet te zbatohet **edhe per kete marke ne baze te vendimit 451 te KPC-se. Neni 451/a, paragrafi i dyte, i KPC-se percakton fare qarte se:** "Vendimi qe ka marre forme te prere ka fuqi vetem per gka eshte vendosur midis po atyre paleve, per te njejtin objekt dhe per te njejtin shkak.";

-Bordi, ne vendimin 66/16 nuk ka trajtuar asnje prej argumenteve te Paditesit, madje as nuk i ka cituar ato ne analizen e vet, per t'u shprehur nese ato qendrojne ose jo, gje qe perben cenim te parimit te procesit te rregullt ligjor;

-Ne kundërshtim me kuadrin ligjor qe normon vendimarrjen dhe argumentimin e saj Bordi, duke qene edhe nje organ me elemente gjyqesore, nuk i ka konsideruar e as shqyrtuar pretendimet e ngritura nga Paditesi, gje qe e ben kete vendim te cenueshem nga pikepamja

procedurale, pasi i kundervihet rregullave qe vendosen nga parimi i procesit te rregullt ligjor te parashikuar ne Kodin e Procedures Administrative.

-DPPI-ja nuk argumentoi apo tregoi se cilet elemente te markes {...} kane prirje te corientojne publikun per natyren, cilesine, origjinen gjeografike, ose tregtare te mallrave qe ajo ka per qellim te dalloje;

- Ne lidhje me nocionin e corientimit apo keqorientimit, EUIPO (Zyra Europiane e Pronesise Intelektuale) ne "Udhezuesit per Ekzaminimin e Markave Tregtare dhe Disenjove te Bashkimit European ne Zyren e Pronesise Intelektuale te Bashkimit European" shtjellon dy situata te ngjashme, se: -nuk ka arsye te presupozohet se nje aplikim per marke eshte depozituar me qellimin per te corientuar konsumatorët. Nuk duhet te behet asnje kundershkrim per corientim nese eshte i mundshem nje perdorim jo- corientues i nje shenje ne raport me mallra dhe sherbime te caktuara - qe do te thote se, presupozimi se perdorimi jo-corientues i shenjës do te behet, kur eshte e mundur; -konsumatori mesatar eshte arsyeshem i kujdesshem dhe nuk duhet te kosiderohet si lehtesisht i ndikueshem nga corientimi. Pergjithesisht, nje kundershkrim mund te behet vetem kur nje marke te con ne nje pritshmeri te natyra ose cilesia ose origjina gjeografike e mallrave sa qe lind nje rrezik serioz i mjaftueshem se konsumatori do te corientohet.

- **Bazuar ne sa me sipër, DPPI nuk ka asnje arsye te presupozoje se {...} eshte corientuese per konsumatorët pare ne raport me mallrat e caktuara te saj** "Birra; ujra minerale e te gazuar dhe pije te tjera jo-alkoolike; pije frutash dhe lengje frutash; shurube dhe preparate te tjera per pergatitjen e pijeve, pije energjike".

{...} nuk permban asnje element tregues apo pershkruet te natyres, cilesise apo origjines gjeografike dhe tregtare te mallrave qe kerkon te dalloje, sic ndalohet ne germen (e) te pikes 1 te nenit 142 te Ligjit 9947. Po ashtu, {...} nuk eshte kontradiktore ne raport me natyren, cilesine apo origjinen gjeografike dhe tregtare te mallrave te saj;

-**Perkundrazi, {...} eshte dalluese per mallrat** "Birra; ujra minerale e te gazuar dhe pije te tjera jo-alkoolike; pije frutash dhe lengje frutash; shurube dhe preparate te tjera per pergatitjen e pijeve, pije energjike.",

-DPPI nuk mund te pretendoje se po zbaton nje vendim gjyqesor perfundimtar kur refuzon regjistrimin e markes {...}, pasi {...} nuk eshte pjese e objektit gjyqesor te ketij vendimi. Rrjedhimisht, efektet e ketij vendimi nuk mund te shtrihen kurrsesi tek {...}. Kjo gjen mbeshtetje edhe tek neni 451/a, paragrafi i dyte, i KPC-se ne te cilin thuhet se: " **Vendimi qe ka marre forme te prere ka fuqi vetem per cka eshte vendosur midis po atyre paleve, perte njejtin objekt dhe perte njejtin** shkak.

-Edhe nese do ta merrnim ne konsiderate krahasimin qe ben DPPI midis markes {...} dhe markes {...} IR1082916, te shfuqizuar me Vendimin 1868, serish DPPI ka vepruar ne kundershkrim me ligjin, sepse {...} nuk eshte identike me marken B-52. Keto dy marka kane emertime te ndryshme, {...} dhe {...}, dhe per kete shkak ato nuk mund te shqyrtohen si identike nga DPPI. DPPI nuk ka ne regjistrin e saj te markave nje marke te meparshme {...}, e cila te konsiderohej si identike me marken {...} qe kerkohej te regjistrohet.

(shpjegimet jane paraqitur te detajuara me shkrim dhe jane te depozituara ne dosje)

Sa me larte pala paditese kerkon pranimin e padise sipas objektit te saj.

**Pala e paditur prapsoi si me poshte:**

-**Se vendimarrja e tyre eshte e** ligjshme dhe produkt i nje procedure ligjore te dhe te faktit te konstatuar prej tyre. Pala e paditur mbeshteti ne menyre te vijueshme argumentin e parashtruar ne aktet e konstatimit dhe te vendimarrjes se saj duke prapsuar per bazueshmeri ne ligj te sjelljes se saj dhe papbazueshmeri ne ligj dhe ne prova te padise se pales paditese;

- Me vendimin e dates 05.10.2017, Gjykata e Larte e RSH, ka lene ne fuqi vendimin nr. 1868, date 06.05.2014, te Gjykates se Apelit Tirane, si vijon: -Shfuqizimin e markes B-52 me nr. regjistrimi IR1082916, me pronar shoqerine "{...}"; - Regjistrimin e ketij vendimi ne regjistrin e markave;

-Pas krahesimit te markes se shfuqizuar me kete vendim gjyqesor dhe te markes se parqitur per regjistrim me aplikimin me nr {...} Nr AL/T/2018-66 ne kuptim te ligjit rezulton te jemi para te njejtës marke;

-Ne nuk mund te regjistrojme nje marke identike me marken e meparshme te shfuqizuar nga gjykata;

-Kjo marke nese do te regjistrohej nga ana jone ne kete menyre jo vetem do te binte ndesh me vendimin gjyqesor por per me teperdo te sillte corientim te publiku.

-Ne kemi kryer ate procedure qe ligji kerkon dhe ne perputhje e ate qe ligji kerkon.

-Ne cdo rast kemi nje vendimarrje pjese te asaj cka eshte konstatuar dhe ne perputhje e ligjin;

-Nuk ka asnje shkak pse te konsiderohet procedura e ndjekur nga ana jone apo vet vendimi jone jo ne perputhje e ligjin ku necdo rast eshte bajtur tersisht e cka ligji kerkon;

-Ne kemi zbatuar si kuadrin ligjor procedural edhe kuadrin ligjor material qe sherben per zbatim ne rastin objekt verifikimi.

(prapsimet jane te paraqitura te detajuara me shkrim dhe te depozituara ne dosje)

Si rrjedhoje pala e paditur sa me larte kerkoj rrezimin e padise.

**c) Kuadri ligjor dhe Zgjidhja juridike e ceshtjes objekt gjykimi.**

Procesi gjyqesor sjelle nje perballje juridike mes paleve ndergjyqese. Kjo perballje konstaton ne ballafaqim pretendimesh, prapsimesh, provash dhe kriteresh apo interpretimesh ligjore te kuadrin ligjor te zbatueshem ne rastin konkret. Procesi gjyqesor qofte ai i posacem administrativ ka dy linja kryesore perballjeje mes paleve ndergjyqese. Perballja lidhur me ligjshmerine e veprimtarise administrative si dhe perballja ne procesin e te provuarit te rrethanave faktike.

Qe ne fillim te ketij argumentimi gjykata thekson faktin se ne rastin objekt gjykimi duke vleresuar pretendimet e pales paditese dhe menyren e trajtimit te mosmarrveshjes nga vet palet ndergjyqese duhet te kihen parasysh keto momente kryesore mbi te cilen eshte ndertuar argumentimi i gjykates:

**1)- Percaktimi i Objektit te gjykimit.**

**Kjo padi e paraqitur per gjykim personifikon nje mosmarrveshje administrative te lindur ndermjet**

pales paditese {...} me Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale (DPPI) subjekt ky i thirrur si pale e paditur ne kete gjykim.

Ne respektim edhe te vendimit unfikues nr 3 viti 2012 te Gjykates se Larte, gjykata pasi u njohe me kerkesepadine dhe me thelbin e pretendimeve te pales paditese konkludon se objekti i gjykimit te kesaj ceshtje jane pretendimet ne temel te vendosura ne padi nga pales paditese per paligjshmeri te:

-aktit administrativ nr. 66/10, date 02.10.2018 Njoftim Refuzim Regjistrim Marke.

-vendimit te Dhomes Per Shfuqizim / Zhvleresim me nr 66/13 prot date 01.02.2019.

- aktit administrativ nr. 66/16, date 11.09.2019 te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale ("DPPI").

Ne kuader te rregullimit te pasojave juridike te pretenduara nga pala paditese si te cenuara nga vendimarrja e pales se paditur kerkohet vazhdimi i procedurave nga DPPI per regjistrimin e markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/66 ne emer te paditesit.

Nga menyra e ndertimit te mbrojtjes pala paditese ne cdo raste identifikonte si linje kryesore te mbrojtjes se saj si me poshte:

-Ka keqzbatim nga pala e paditur te kuadrit ligjor per rastin objekt gjykimi si ne identifikimin e gjendjes se faktit edhe ne marrjen e vendimit te saj te atakuara ne kete gjykim per paligjshmeri nga pala paditese.

**Ky eshte edhe objekti i padise dhe objekti i gjykimit pasi ne nenin 31 te Kodit te procedures Civile (K.Pr.C) parashikohet se: *"Padia eshte e drejta e personit qe ben pretendimin, per t'u degjuar, mbi themelin e ketij pretendimi, ne menyre qe gjykata ta shpalle ate te bazuar ose jo. Pala kundertshtare ka te drejte te diskutoje dhe te ngreje prapesime mbi themelin dhe bazueshmerine ne ligj te ketij pretendimi"*.**

Gjithashtu ne nenin 17/ a te Ligjit nr. 49 te vitit 2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative" parashikohet se: *"Padia ngrihet: a) per shfuqizimin teresisht apo pjeserisht te aktit administrative"*.

Per percaktimin e thelbit dhe objektit te mosmarrveshjes gjykata mban parasysh edhe nenin 5 te K.Pr.Civile ne te cilin parashikohet si me poshte: *"Objekti i mosmarreveshjes percaktohet ne pretendimet e paleve. Pretendimet parashtrohen ne aktin per fillimin e procesit gjyqesor, si dhe gjate ushtrimit te te drejtave qe rrjedhin nga ky proces. Objekti i mosmarreveshjes mund te ndryshoje sipas kerkesave qe lindin gjate procesit, kur keto te fundit kane lidhje te mjaftueshme me pretendimet e fillimif."*

## 2) *Procesi i te provuarit dhe paraqitja e fakteve objekt verifikimi.*

Nje moment kyc ne gjykimin administrativ eshte edhe procesi i provueshmerise te fakteve objekt verifikimi. Nje proces gjyqesor identifikon nevojen ligjore qe palet ndergjyqese te paraqesin faktet mbi te cilat mbeshtesin pretendimet apo prapsimet e tyre (neni 8 i k.pr.civile). Gjykata fton palet ndergjyqese per te dhene shpjegime mbi faktet qe ajo i vlereson te nevojshme per zgjidhjen e mosmarreveshjes. (neni 9 i K.pr.civile). Gjykata mbeshtet vendimin e saj vetem mbi faktet qe jane paraqitur gjate procesit gjyqesor. (neni 10 i K.Pr.Civile).

I lidhur drejteperdrejte me faktet objekt verifikimi dhe me nevojen ligjore per provueshmerine e tyre eshte koncepti i barres se proves. Barra e proves (*onus probandi*) eshte percaktimi i pales ne proces, e cila duhet te provoje faktin e pretenduar me mjetet provuese. Faktet qe kane qene objekt i te provuarit gjykata i merr per baze ne dhenien e vendimit, vetem kur ato jane paraqitur me saktesi dhe ne formen e kerkuar nga ligji gjate procesit gjyqesor. Per te formuar bindjen e saj gjykata duhet te marre parasysh si argumentet qe flasin per ekzistencen e nje fakti ashtu edhe argumentet qe flasin per mosekzistencen e tij.

Provat jane te dhena qe merren prej burimeve dhe sipas rregullave te parashikuara ne kete Kod dhe ligje te tjera, te cilat vertetojne ose rrezojne pretendimet ose prapesimet e pjesemarrvesve ne proces. (neni 11 i K.Pr.Civile). Pala qe pretendon nje te drejte, ka detyrim qe, ne perputhje me ligjin, te provoje faktet mbi te cilet bazon pretendimin e saj (neni 12 i k.pr.civile).

Ne lidhje me kete moment dhe me konceptin e provueshmerise Gjykata cmon te terheqe ne vemendjen e paleve ndergjyqese dhe ne kete gjykim te posacem administrativ permbajtjen e nenit 35 te Ligjit nr. 49 te vitit 2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative".

Ne kete nen parashikohet shprehimisht se: *"Organi publik ka detyrimin te provoje ligjshmerine e aktit administrativ, kontrates administrative dhe te veprimit tjeter administrativ, te nxjerre jo me kerkesa te paditesit, si dhe faktet qe ai ka parashtruar dhe ka vene ne temel te veprimtarise se kundertshtuar ne gjykate. Organi i administrates publike ka detyrimin te provoje ligjshmerine e veprimeve ne marredhenien e punes, nga e cila ka lindur mosmarreveshja, objekt gjykimi. Ne rastet e tjera, pala ka detyrimin te provoje faktet, ne te cilat bazon pretendimin e saj. Por edhe ne keto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim te ndermjetem, mund te vendose kalimin e barres se proves tek organi publik, kur ka dyshime te arsyeshme, te bazuara ne prova me shkrese, qe vertetojne se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova te rendesishme per zgjidhjen e mosmarreveshjes. Ky vendim ankimohet se bashku me vendimin perfundimtaf'.*

Ky eshte nje moment i rendesishem per tu mbajtur parasysh ne gjykimin e posacem administrativ. Pasi ligjshmeria e veprimtarise administrative (ne cdo forme qofte ajo) eshte detyrim per tu provuar nga pala e paditur organ publik. Pra barra e proves per te provuar se

akti administrativ objekt atakimi ne gjykate eshte i ligjshem dhe per rrjedhoje nuk duhet te cenohet vlefshmeria e tij i takon organit publik te thirrur me cilesine e pales se paditur ne gjykim. Por theksohet nga gjykata se ne ceshtjen objekt gjykimi kerkohet paligjshmeria e aktit qe kundershohet. Ne kete kontekst kjo padi percakton llojin e gjykimit, objektin e hetimit kufijt e pretendimeve dhe kufijt e prapsimeve te pales se paditur.

Gjykata terheqe ne vemendjen e paleve ndergjyqese se menyra sesi palet ndergjyqese kerkojne te mbrohen ne gjykim identifikon edhe nevojën e aplikimit te parimit klasik te barres se proves. Pala qe ka pretendime te mbeshtetura ne fakte te identifikuar prej saj ka dhe detyrimin per te paraqitur proven qe provon ate fakt. Koncepti i barres se proves per organin publik ne cdo rast identifikohet si nevojë ne gjykim qe ky i fundit duhet te identifikojë ne gjykim proceduren administrative te ndjekur prej tij, bazueshmerine e saj ne ligj dhe identifikimin e provave te gjetura, te marra te vleresuara ne kete procedure administrative dhe te marra parasysht prej organit publik ne momentin qe ka nxjerre aktet administrative objekt kontestimi ne kete gjykim.

Pra palet ndergjyqese kane barren e proves per te provuar faktet ku ato mbeshtetin pretendimet, kerkimet dhe prapsimet e tyre. Barra e proves ne progesin gjyqesor eshte e lidhur ngushtesisht me linjen e ndertimit te mbrojtjes te seciles prej paleve ndergjyqese dhe me interesin e tyre per te provuar faktet ku ato mbeshtetin pretendimet e tyre. Ne nje proges gjyqesor faktet objekt verifikimi mund te jene fakte formuese apo konstitutive. Faktet formuese apo konstitutive jane faktet qe sjellin lindjen e nje te drejte. Faktet formuese gjate progesit gjyqesor duhet te provohen nga pala qe pretendon egzistencen e tyre, pra barren per te provuar keto lloj faktesh objekt verifikimi e ka pala qe pretendon lindjen e nje te drejte (zakonisht paditese).

Pikerisht duke patur parasysht keto karakteristika te konceptit te fakteve objekt verifikimi, te barres se proves gjykata zgjidhi ceshtjen ne perfundim te gjykimit.

### **3. Mbi crrethana faktike dhe ligjore do te vleresohet paligjshmeria e pretenduar te akteve te kontestuar ne kete gjykim?**

Ne nenin 37 te po ketij ligji parashikohet se: **“1. Gjykata shqyrton ligjshmerine e veprimit administrativ qe kundershohet, ne baze te provave te paraqitura nga palet dhe te situates ligjore dhe faktike qe ekzistonte ne kohën e kryerjes se veprimit konkret administrative”.** Ne respektim te nenit 37 te ligjit 49/2012 gjykata i referohet paligjshmerise si nje koncept i njohur dhe i parashikuar ne ligjin Nr.44/2015, Kodi i Procedurave Administrative dhe kuadrit ligjor ne fuqi qe ka normuar veprimtarine administrative te pales se paditur ne marrjen e vendimeve qe atakohen nga pala paditese.

Gjithashtu per shqyrtimin e ceshtjes gjykata per te vleresuar pretendimet e pales paditese i referohet gjendjes faktike te kohes se nxjerrjes se aktit objekt kontestimi. Cdo ndryshim ne kuader ligjor dhe cdo rrethane faktike pas ketij momenti nuk merret parasysht nga gjykata ne zgjidhjen drejte te ceshtjes.

### **4) Pretendimet e pales paditese dhe bazueshmeria e tyre ne prova dhe ne ligj.**

Vlen te theksohet per palet ndergjyqese qe te gjitha paragrafet e sipercituara ne kete vendim kane kornizuar argumentimin e gjykates ne konkludimin e saj per: -objektin e gjykimit; per kufijte e shqyrtimit te ceshtjes; - per procesin e te provuarit. Keto momente jane te inkorporuara ne te gjithë permbajtjen e vendimit te poshte argumentuar.

Ashtu dhe si eshte sipercituar pala paditese ne kete gjykim ngre pretendime per paligjshmeri te akteve te marra nga pala e paditur DPPI qe kane bere refuzimin e kerkeses se pales paditese per regjistrimin e markes {...} Nr AL/T/2018-66.

Per te vleresuar drejte kete pretendim te pales paditese gjykata mban parasysht konceptin e ligjshmerise dhe te paligjshmerise te nje akti administrativ te normuar nga Kodi i Procedurave Administrative.

Perkatesisht ky kod ne nenin 107 te tij parashikon se: **“Akti administrativ eshte i ligjshem nese eshte nxjerre nga organi publik kompetent, ne perputhje me parimet dhe kerketat ligjore te parashikuara ne kete Kod, si dhe legjislacionin ne fuqi”.**

Me tej ne nenin 109 te K.Pr. Ad jepet koncepti i paligjshmerise se aktit. Ne kete nen parashikohet se: **“Nje akt administrativ eshte i paligjshem nese: a) organi publik qe e ka nxjerre ka vepruar ne mungese te kompetences; b) eshte rezultat i shkeljes te dispozitave lidhur me proceduren administrative; c) eshte ne kundershitim me dispozitat qe rregullojne formen apo elementet e detyrueshme te aktit administrativ; g) eshte nxjerre ne mungese te autorizimit nga nje ligj, sipas pikes 2, te nenit 4, te ketij Kodi; d) eshte ne kundershitim me ligjin material; dh) eshte rezultat i diskrecionit te ushtruar ne menyre jo te ligjshme; apo e) nuk eshte ne perputhje me parimin e proporcionalitetit’.**

Ne rastin objekt verifikimi pales paditese i eshte refuzuar kerkesa per regjistrimin e markes {...} Nr AL/T/2018-66 bazuar ne nenin 142 te ligjit nr 9947 date 07/07/2008 “Per pronesine industrial”. Perkatesisht ne kete nen parashikohet se: **“1. Qdo shenje ose kombinim shenjash, qe paraqitet grafikisht dhe qe sherben per te dalluar mallrat apo sherbimet e nje personi fizik ose juridik, nga ato te nje personi tjeter fizik ose juridik, eshte marke qe perfaqeson ato mallra ose sherbime, me kusht qe te permbushen kerketat e neneve 141 deri ne 143 te ketij ligji (ne vijim do te quhet “marke”). 2. Perbejne marka shenjat e meposhtme: a) fjalet, perfshire emrat personale, shkronjat, numrat, shkurtimet; b) shenjat figurative, perfshire vizatimet; c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre; g) kombinimet e ngjyrave e te drite-hijeve, si dhe ngjyrat ne vetvete; d) gdo kombinim**

*i shenjave, te permendura nga shkronjat “a” deri ne “g” te kesaj pike. 3. Markat regjistohen vetem nese ato mund te paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veganerisht me lloje te veganta markash, si zeri dhe sinjalet e drites, por jo vetem me keto. Neni 141 Karakteri dallues 1. Nje shenje ka karakter dallues, nese nepermjet saj perdoruesi i zakonshem dallon nje numer mallrash dhe sherbimesh specifike, nga nje tjeter numer mallrash dhe sherbimesh, te njejta me te parat, e lidhur, perkatesisht, me origjinen tregtare te tyre. 2. Karakteri dallues i nje shenje vleresohet ne lidhje te ngushte me mallrat dhe sherbimet, te cilat shenja ka per qellim t'i dalloje. Neni 142 Refuzimi per shkaqe absolute 1. Nje shenje nuk regjistrohet si marke nese: a) nuk ka karakter dallues; b) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, origjinen gjeografike ose kohën e prodhimit te mallrave apo te kryerjes se sherbimeve, ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo te sherbimeve; c) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe jane bere te zakonshem ne gjuhen e perditshme apo qe jane kthyer ne praktika tregtare; g) perbehet nga forma ose vija, te imponuara nga vete natyra e mallrave apo e sherbimeve dhe/ose forma apo linja thelbesore, per te permbushur nje rezultat teknik; d) perbehet nga forma, qe u japin mallrave nje vlere thelbesore; dh) perbehet nga elemente, qe cenojne interesin publik ose qe bien ne kundërshtim me vlerat morale apo rendin publik; e) perbehet nga elemente, qe kane prirje te gorientojne publikun per natyren, cilesine, origjinen gjeografike te mallrave dhe/ose sherbimeve, qe ato kane per qellim te dallojne; e) perbehet nga tregues gjeografike, per vererat ose pijet alkoolike, qe nuk e kane origjinen gjeografike nga vendet, qe tregohen ne keta tregues, edhe nese tregohet origjina e vertete e produkteve, ose treguesit gjeografike jane perkthyer apo shoqeruar me shprehje te tilla, si “lloji” “tipi” “stili” “imitimi” ose shprehje te ngjashme; f) perbehet nga emra, portrete, pseudonime personale, te mirenjohura ne Republiken e Shqiperise, per perdorimin e te cilave nuk eshte dhene autorizim nga vete personi ose pasardhesi i tij; g) perbehet nga: i) emra shtetesh (te plote ose te shkurtuar); ii) emblema shteterore, medalje, urdhra nderi; iii) vula dhe shenja zyrtare te miratuara nga vendi; iv) emblemat e organizatave te njohura nderkombetare ose shkurtimet e tyre; v) simbolet fetare; vi) flamujt kombetare; gj) perbehet nga elemente, qe bien ne kundërshtim me nenin 6 bis te Konventes se Parisit. 2. Nje shenje nuk perjashtohet nga regjistrimi si marke, ne perputhje me shkronjat “a”, “b” e “c” te pikes 1 te ketij neni, ne qofte se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues ne procesin e perdorimit perpara dates se aplikimit.*

Eshte e rendesishme te theksohet se procesi gjyqesor kerkon ne menyre te njekoheshme te provohen dy momente nevojë per zgjidhje drejte te ceshtjes:

-Ekzistenca apo jo e nje te drejte te ligjshme ne themel te padise dhe;

-Ekzistenca apo jo e nje vendimarrje jo ligjore apo ligjore e pales se paditur organ publik.

Sa me larte pala paditese duhet te provoje ne gjykim qe ajo eshte zotruese dhe titullare e nje te drejte ligjore te njohur dhe te normuar nga ligji dhe te cenuar nga sjellja e pales se paditur. Ne nje kohe qe pala e paditur ka detyrimin per te provuar se sjellja e saj eshte tersisht ne perputhje me ligjin. Ne rastin konkret objekt gjykim eshte pala paditese Bavari N.V ajo qe ka detyrimin per te provuar se kerkesa e paraqitur me pare ne kohe prane pales se paditur DPPI per regjistrimin e markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/66 ne emer te paditesit eshte nje kerkese tersisht ligjore dhe e ka burimin ne ligj. Ne nje kohe qe pala e paditur DPPI ajo qe duhet te provoje ne kete gjykim se vendimarrja e saj eshte ne perputhje me ligjin.

Vetem ne rast se provohen keto dy momente te rendesishme te gjykimit padia e pales paditese rezulton e bazuar ne ligj dhe gjykata me forcën e saj shtrenguese mbron nje te drejte te ligjshme te pretenduar me padi dhe ndal nje paligjshmeri te pretenduar te ardhur nga sjellja administrative e organit publik.

Gjykata e thekosen kete moment per te terhequr vemendjen e paleve ndergjyqse qe forca



shtrenguese e gjykates kerkohet vetem per te garantuar dhe rivendosur ne vend nje te drejte te ligjshme. Njekohesisht forca shtrenguese e gjykates kerkohet nga pala paditese me qellimin te ndalet nje veprimatri e paligjshme e pales se paditur organ publik.

Pas verifikimit te njekoheshem te te dy ketyre momenteve te argumentuara me latye gjykata konkludoi se pala paditese me kete padi nuk ka nje te drejte te ligjshme te lindur dhe prezent ne kohen e gjykimit. Gjykata arriti ne kete konkluzion pasi konkludoi se kerkesa e pales paditese per regjistrimin e markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/66 ne emer te paditesit nuk gjene mbeshtetje ne ligj dhe bie ndesh me vet nenin 142 te ligjit te sipercituar.

Gjykata arriti ne kete konkluzion pasi vleresoi kerkesen per regjistrimin e markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/66 ne emer te paditesit ne raport me kontekstin faktik te provuar dhe kontesktit ligjor ne fuqi te zbatueshem per rastin objekt gjykimi.

Neni 142 i ligjit i sipercituar ne permbajtjen e tij parashikon rastet kur nje kerkese per regjistrim marke duhet te refuzohet per nje shkak absolut. Perkatesisht ky nen parashikon te listuara shkaqet absolute ligjore qe ndalojne regjitrimin e markes dhe kerkojne refuzimin e regjistrimit te markes. Nese nje marke bie ndesh me keto kushte te parashikuara ne nenin 142 te ketij ligji eshte automatikisht nje marke e refuzuar per regjistrim. Por ajo gjithashtu personifikon mos lindjen me te nje te drejte ligjore per palen paditese qe eshte edhe pala qe kerkon regjistrimin e saj. Pasi pala paditese ka detyrimin per te provuar ne gjykim se marka qe ajo kerkon te regjistroje jo vetem qe nuk eshte marke perjashtuese nga vet ligji per regjistrim por ajo eshte nje marke ne perputhje me kete ligj. Vetem ne kete menyre pala paditese provon legjitimitetin e saj aktiv ne kete gjykim dhe faktin se ajo eshte nje zotruese e te drejtes ligjore.

Ne rastin konkret po te vleresohet kerkesa regjistrimin e markes {...} me numer aplikimi AL/T/2018/66 dhe te dhenat identifikuese te markes qe kerkohet te regjistrohet rezulton qartesisht se regjistrimi i kesaj marke do te corientoje publikun pasi qe ne momentin e "parjes" se kesaj marke dhe konsuminin e produktit ne publik krijohet kohezion dhe corientim te vet publiku. Ky kohezion dhe ky corientim te publiku vjen:

-per shkak te ngjashmerise se saj me marken tregtare B-52, pije energjike me date regjistrimi 19.02.2008 dhe me nr. regjistrimi 1153546;

- per shkak te ngjashmerise se saj me marken qe ka egzistuar me pare ne treg B-52 ne emer te vet pales paditese Shoqeria "{...}." me nr regjistrimi 1082916.

Gjykata arriti ne kete konkluzion pasi vleresoi se marka qe kerkohet te regjistrohet ka te beje me te njejtin natyre produkti me te dy produktet e trgtuara ne respktim te te drejtave te fituara me pare nga subjektet respektiv dhe qe kane ekzistuar ne treg dhe per konsum ne publik pavarsisht se njera marke sot eshte e cregjistruar. Publiku eshte indiferent ne lidhje me njohjen e detajve proceduriale te regjistrimit dhe cregjistrimit te markave nga DPPI apo subjektet privat por njeh dhe vlereson produktin qe i ofrohet ne konsum ne kohe.

Publiku si nje vezhgues dhe perdorues i produkteteve te tregtuara nen keto marka ne kohe patjeter qe behet konfuz dhe corientohet kur ne kohe te ndryshme i ofrohen per konsum tre pije energjike nga markat e sipercituara dhe nga marka qe kerkohet te regjistrohet nga pala paditese. Publiku dhe konsumatori ne jetgjatesine e tij vihet ne kohe te ndryshme produkte me nje njashmerie te nje niveli te larte qe sjelle konfuzion per nje vezhgues objektiv dhe me njohjen te nivelit mesatar te tregut, te produktit dhe te konsumit te vet produktit qe i ofrohet ne kohe.

Kjo vjen pasi ne menyre krej reale marka qe regjistrohet per shkak te ngajshmerise me te dy markat e sipercituara nuk arrin me te identifikojte nje karkater te saj dallues. Ne kete menyre patjeter qe publiku me nje njohje normale dhe mestare te mallrave ne treg behet konfuz ne zgjedhjen e tij dhe corientohet ne raport me zgjedhjen dhe mallin qe kerkon do te konsumoje dhe ate qe ai do te konsumoje realisht.

Ky moment eshte evident pasi kjo marke qe kerkohet te regjistrohet nuk ka asnje kriter dallues identifikues te saj ne menyre qe te shmang corientimin ne kohe te publikut ne raport me mallin qe tregtohet me kete marke.

Ne nenin 141 te ligjit parashikohet se: *1. Nje shenje ka karakter dallues, nese nepermjet saj perdoruesi i zakonshem dallon nje numer mallrash dhe sherbimesh specifike, nga nje tjeter numer mallrash dhe sherbimesh, te njejta me te parat, e lidhur, perkatesisht, me origjinen tregtare te tyre. 2. Karakteri dallues i nje shenje vleresohet ne lidhje te ngushte me mallrat dhe sherbimet, te cilat shenja ka per qellim t'i dalloje”.*

Nekete logjike juridike vjen dhe parashikimi ne piken 8, te nenit 22, te VKM nr. 315, date 31.05.2018 "Per miratimin e rregullores se markave" ku parashikohet shprehimisht: *“Markat do te konsiderohen identike kur ne pamje te pare ato nuk dallojne ose ndryshojne vetem ne aspekte te parendesishme nga njera-tjetra”.*

Me te drejte pala e paditur DPPI ka analizuar ne vendimarrjen e saj se si rezultat i krahasimit te dy shenjave te mesiperme, Dhoma per shfuqizim/ zhvleresim ka vleresuar se te dyja markat jane identike, sepse marka me nr. Aplikimi AL/T/2018/66 permban te riprodhuara ne menyre identike, te pozicionuara identikisht dhe me te njejta proporcione, te gjitha elementet e markes se shfuqizuar. Diferenca e vetme qe rezulton nga krahasimi i hollesishem i cdo elementi, eshte rrumbullakesia e kendeve te elementeve literale te markes me nr. aplikimi AL/T/2018/66. Por per shkak te vleres teper te vogel qe diferencat kane ne kete krahasim, ndryshimi i sjelle nga ky shkak vleresohet i paperfillshem dhe si rrjedhim markat vleresohen identike.

Ne lidhje me kete moment dhe kete konkluzion te arritur nga DPPI vlen te theksohet se ne kuader te zbatimit te ligjit 9947/2018 organi kompetent i njohur dhe i percaktuar dhe i identifikuar nga ligji, DPPI ka pushtetin ligjor per te vleresuar dhe interpretuar shkaqet absolute te refuzimit te markes. Vendimarrja e te ciles behet objekt verifikimi ne gjykate dhe nje nga shkaqet e paligjshmerise se aktit administrativ dhe vendimarrjes se DPPI eshte edhe fakti nese akti vet eshte rezultat i diskrecionit te ushtruar ne menyre jo te ligjshme nga organi publik.

Pra kompetenca/ pushteti qe ligji i ka deleguar DPPI ne marrjen e ketij vendim padiskutim ben fjale per nje pushtet ekskluziv te percaktuar nga ligji per DPPI. Por ky pushtet diskrecion dhe marzhi vleresimi nga pala e paditur ne kerkesen e paraqitur duhet te matet ne gjykim nepermjet kriterave objektive dhe provave te paraqitura ne gjykim.

Kufijte e shqyrtimit te gjykimit te kesaj ceshtje ne koncept te gjykimit administrativ bene nje referim ekskluziv tek vet ligji organik, organi publik kompetent dhe i specializuar per te marre vendimet respektive. Dhe ky mund te quhet nje territor ku ekskluziviteti i vleresueshmerise se rrethanave konkrete i takon organit kompetent DPPI. Ky ligj rregullon veprimtarine e DPPI. Eshte pikerisht pala e paditur DPPI organi kompetent rregullator ne fushen e regjimit juridik te markave dhe gjykata nuk ka per qellim te mbivendoset mbi te. Ne kete fushe gjithmone vendimarrja organit publik ne menyre te vacant ne raste specifike si ne rastin konkret mbart nje diskrecion. Ky diskrecion eshte i mateshem nga gjykata kryesisht ne nivelin e vleresimit te elementeve objektive qe parashikon ligji dhe qe instruktore vendimarrjen e organit publik.

Ne kete kontekst gjykata vlereson ligjshmerine e veprimtarise se DPPI duke u mbeshtetur ne problematikat procedurale dhe ne matjen te kriterave objektive te cilat do te nxjerrin ne pah nese vendimarrja konkrete e atakushme ne gjykate e organit publik eshte bere apo jo ne perputhje me kuadrin ligjor te detyrueshem per tu zbatuar nga pala e paditur.

Ky moment vleresimi i diskrecionit te pushtetit te DPPI ne rastin konkret ka nje vlere parimore ne vet te drejten administrative. Perkatesisht ne nenin 11 te K.Pr.Ad parashikohet normohet parimi i ushtrimit te ligjshem te diskrecionit. Ne kete nen parashikohet se: Diskrecioni ushtrohet ligjerisht kur ai eshte ne perputhje me kushtet e meposhtme: a) eshte i parashikuar me ligji; b) nuk tejkalon kufijte e ligjit; c) zgjedhja e organit publik eshte bere vetem per te arritur objektivin per te cilin eshte lejuar diskrecioni dhe eshte ne perputhje me parimet e pergjithshme te ketij Kodi; dhe; 5) zgjedhja nuk perben nje shmangie te pajustificuar nga vendimet e meparshme te marra nga i njejti organ ne raste te njejta apo te ngjashme.

Ne kete kontekst gjykata pasi njihet me provat ne gjykim dhe vlereson ecurine e se gjendjes se faktit dhe te kuadrit ligjor vlereson se nuk ka shkelje ne diskrecionin dhe vleresimin e tij nga pala e paditur DPPI.

Gjithashtu me te drejte vleresohet edhe argumentimi i bere nga pala e paditur ne raport me faktin se krahes ngjashmerise se sipercituar mes markes qe kerkohet te regjistrohet {...} me aplikimin me Nr AL/T/2018-66 me marken {...} me nr. AL/T/2018/66 te regjistruar dhe te cregjistruar me pare ne kohe kjo marke ka te njejtin raport me edhe me marken tregtare B-52, pije energjike aktualisht e regjistruar dhe me mall te hedhur ne treg aktiv.

Gjykata thekson per palet ndergjyqese qe ne cdo rast per zgjidhjen drejte te ceshtjes gjykata terhiqet nga parimi i zgjidhjes se thelbit te mosmarrveshjes dhe zgjidhjes perfundimtare te ceshtjes objekt gjykimi. Ky moment eshte terper i rendesishem pasi ne cdo mbrojtje te paleve apo qendrim te ne vendimarrjet e atakueshme te organeve publike qelimi ehste mbrojtja e nje te drejte te ligjshme dhe gjykata qendron mbi palet dhe e pavarur nga percaktimi i fakteve qe palet iu bejne fakteve objekt verifikimi.

Pavarsisht se siperifrazohet mbrojtja e paleve ndergjyqese gjykata zgjidh ceshtjen ne thelb. Ne kete kontekst prapsimet per gjene e gjykuar te pales se paditur apo pretendimi per mos qenie para ketij parimi jane pretendimet dhe prapsime qe derivohen nga palet ndergjyqese ne nje menyre te panevojshme per llogari te zgjidhjes se ketij gjykimi. Pasi interpretoimi dhe permbajtja e vendimit te gjykates se larte qe ka zgjidhur mosmarrveshje te meparshme ka vlere per efekt te ketij gjykim ashtu si cdo prove tjeter shkresore ne raport me



faktin qe kjo prove kerokon te provoje.

Ne kushtet kur nga gjykimi rezultoi katerciprisht e provuar se marka qe pala paditese kerkon te regjistroje eshte nje marke qe per shkak te kontaktit dhe gjendjes se faktit te kohes qe ajo kerohet te regjistrohet ka element qe kane prirjen te corientojne publikun ne raport me produktin qe do te trgtohet nene kete marke. Ky kohezion dhe ky corientim eshte pasoje e drejte per drejte e faktit qe kjo marke nuk ka karakter dallues ne raport me markat e tjera qe kane operuar ne treg pavarisht faktit qe njera prej tyre eshte cregjistruar. Pasi edhe arsytet e ketij cregjistrimi te ndodhur mbi kete mark te meparshme te pales se paditur jane arsye qe shkojne unison me sa me siper cituar ngjashmeria e saj me nje marke te meparshme te regjistruar nga DPPI.

Sa me larte gjykata konkludon se kerkese e paraqitur nga pala paditese Bavaria NV prane pales se paditur DPPU per regjistrimin e produktit {...} me aplikimin me Nr AL/T/2018-66 eshte nje kerkese qe bie ndesh me nenin 142 te ligjit. Si rrjedhoje gjykata konkludoi se ne kete menyre pala paditese deshtoi per te provuar para gjykates qe eshte zotruese e nje te drejte ligjore. Ne nje kohe qe pala e paditur provoi ne gjykim dhe bindi Gjykatën per shkak te ngjashmerise se markes qe kerkohej te regjistrohet me:

- marken tregtare B-52, pije energjike me date regjistrimi 19.02.2008 dhe me nr. regjistrimi 1153546;
- me marken qe ka egzistuar me pare ne treg B-52 ne emer te vet pales paditese Shoqeria "{...}." me nr regjistrimi 1082916.

ne kendveshtrim dhe te konkluzioneve te arritura me vendimin e Gjykates se Larte bejne qe kerkesa e pales paditese te jete e paligjshme per shkaqet e sipercituara dhe vendimarrja e pales se paditur te jete nje vendimarrje e ligjshme.

Gjykata ne perfundim te kesaj analize ligjore te fakteve objekt verifikimi duke vleresuar kerkimet e pales paditese, prapsimet e pales se paditur, raportin shkak ligjor - baze juridike objekt kerkimesh pasi gmoi provat e marra ne gjykim vendos te rrezoje kerkese - padine si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.

### Per keto arsye

#### Baza Ligjore:

**Gjykata mbeshtetur ne nenet 1, 39 - 43 te Ligjit nr. 49 te vitit 2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"; K.Pr.Civile; Kodi i Procedurave Administrative, ligji nr 9947 date 07/07/2008 "Per pronesine industrial".**

### VENDOSI:

#### Vendosi:

### V E N D O S I

1. Rrezimin e kerkese-padise.
1. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.
2. Kunder ketij vendimi lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Administrativ Tirane brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga dita e neserme shpalljes se ketij vendimi.
3. U shpall ne Tirane, sot me date 27.07.2020.

SHPENZIMET GJYQESORE 3 200 LEK

### SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:  
{...}

